REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 315/20
Datë/Datum. 09.06.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues/Teknik dhe nënshkrimi ***Dior Halili*** ***Valon Jahaj***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***01/06/2020***	*Data e dorëzimit të raportit* *09/06/2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

OE "ASSECO SEE"- SH.P.K - Prishtinë, si palë e pakënaqur në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te datës 11.05.2020, me datë 18.05.2020 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së me nr. të lëndës **315/20**, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit: **"Furnizimi dhe instalimi i softwerit sistemi ERP"** me numër të prokurimit: **IL-19-9673-1-2-1,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e 49,000.00€. Kriteri i dhënies së kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së prokurimit deri në ankesë janë si në vijim:
Njoftimi për kontratë: 30.12.2019
Afati për dorëzimin e Tenderëve: 23.01.2020
Ankesa 1 në OSHP: 23.01.2020
Vendimi i OSHP-së: 02.03.2020
Njoftim për përmirësim te gabimit 1: 09.03.2020
Njoftim për përmirësim te gabimit 2: 23.03.2020
Afati i Fundit për Dorëzim: 06.04.2020
Njoftimi për vendimin e AK-së: 06.05.2020
Kërkesa për Rishqyrtim: 11.05.2020
Përgjigja në kërkesën për Rishqyrtim: 14.05.2020
Ankesa në OSHP: 18.05.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE "ASSECO SEE"- SH.P.K - Prishtinë, si palë e pakënaqur në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te datës 11.05.2020, me datë 18.05.2020 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së me nr. të lëndës **315/20**, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit: **"Furnizimi dhe instalimi i softwerit sistemi ERP"**me numër të prokurimit: **IL-19-9673-1-2-1,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.** OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Neni 28.9 i LPP-së
Neni 59 paragrafi 2
Neni 108A, paragrafi 8.4

OE ankues thotë që janë njoftuar me shkrim nga AK lidhur me eliminimin përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar. Konform nenit 108/A te Ligjit nr. 05/ L-068 për plotësim dhe ndryshim te ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik, me date 11.05.2020 ata kanë dorëzuar kërkesën për rishqyrtim te vendimit pranë AK ku kanë shprehur mospajtimet lidhur me eliminim. Me date 14.05.2020 OE ankues ka pranuar vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim. Ne arsyetimin e dhënë nga AK jepen te njëjtat arsye për eliminim, te cilat janë dhenë ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, pa u adresuar asnjëra nga mospajtimet e paraqitura ne kërkese.

Neni 28 paragrafi 9 i LPP-së;- (PRETENDIMI 1)
Ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka konsideruar se ASSECO SEE është i papërgjegjshëm duke qene se nuk i ka plotësuar specifikat teknike te dosjes se tenderit te listuara si ne njoftimin e dhenë. Mbi këtë baze ASSECO SEE konsideron se ka shkelje te Nenit 28 te LPP, përkatësisht paragrafit 9, duke qene se AK nuk e ka marre parasysh deklaratën e ASSECO e cila është pjese përbërëse e tenderit/ofertës se tyre, ne te cilën ne mënyrë eksplicite konfirmohet se ASSECO do te përmbush te gjitha kërkesat funksionale dhe jo funksionale nga dosja e tenderit ne fjale, sipas kushteve te kërkuara nga AK ne dosjen e tenderit.
Rrjedhimisht, konsiderojmë se AK nuk e ka marre për baze paragrafin 9 te nenit 28 te LPP-se ku thuhet se "tenderuesi duhet te paraqesë ne tenderin e tij ne mënyrën me te përshtatshme qe produkti ose shërbimi janë ne përputhshmëri me specifikat e lartpërmendura, gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale te autoritetit kontraktues", ndërsa deklarata e ASSECO është pikërisht ajo qe kërkohet nga kjo dispozite.

Për me tepër, lidhur me arsyet e eliminimit te ASSECO SEE, me poshtë i gjeni përgjigjet për secilën pike:

a) *Kërkesa 2.2: Duke marre parasysh qe sistemi i ofruar është platforme UEB nënkupton qe sistemi funksionon ne browser te ndryshëm përfshire Firefox edhe ne platformën mobile.*
b) *Kërkesa 3.8: Sistemi jone i ofruar është sistem i cili aktualisht funksionon ne ndërmarrje publike qe kane faturim masiv dhe qe e përdorin lidhjen e pagesave me fatura sipas parimin nga "me e vjetra" andaj kjo kërkesë mundësohet përmes sistemit tone dhe është pjese e konfigurimit te sistemit gjate implementimit.*
c) *Kërkesa 2.10: Automatic Backup and Restore mundësohet nga sistemi jone i ofruar dhe kjo konfigurohet gjate fazës se implementimit.*
d) *Kërkesa 3.14: Është veçori standard e sistemeve ERP andaj edhe sistemi i ofruar nga ne e përkrahë përllogaritjen e kostos se mallit sipas metodës FIFO.*
e) *Sistemi i ofruar nga ne është i konfigurueshëm andaj mund te konfigurohet qe te mundësohet gjurmimi i artikujve sipas numrit serik.*
f) *Sistemi i ofruar nga ne është platformë e hapur për integrime te ndryshme përfshirë edhe atë me access control. Si produkt final pas implementimit sistemi i ofruar nga ne përfshinë edhe Self Service i cili gjate fazës se implementimit konfigurohet sipas kërkesave specifike te autoritetit kontraktues.*

Neni 59 paragrafi 2;- (PRETENDIMI 2)
Nëse AK do te kishte dilema se tenderi i ASSECO SEE nuk i përkrah ndonjërën nga kërkesat e parashtruara ne dosje te tenderit, edhe pse askund ne ofertën/tenderin e ASSECO SEE nuk konfirmohet se ndonjë kërkesë nuk mund te përkrahet nga sistemi i ofruar dhe përkundrazi është deklarata e ASSECO SEE e cila konfirmon pikërisht te kundërtën e konstatimit te AK se ne tenderin e ASSECO SEE ka kërkesa qe nuk përkrahen nga sistemi i ofruar, AK do te duhej te zbatonte nenin 59.2 te LPP-se duke kërkuar informata shtese nga ASSECO SEE lidhur me sqarimin e cilitdo nga aspektet e tenderit te tij.

Neni 108/A, paragrafi 8.4– (PRETENDIMI 3)
Ne arsyetimin e vendimit te AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim te vendimit për eliminim, AK ne asnjë pjese te saj nuk e ka shqyrtuar çështjet qe janë ngritur nga Ankuesi lidhur me shkeljet e supozuara te nenit 28.9 i LPP-së dhe Nenit 59 paragrafi 2. Vendimi i AK lidhur me kërkesën per rishqyrtim është përsëritje e arsyetimeve nga njoftimi për eliminim dhe nuk ka adresim te çështjeve qe janë kërkuara nga ankuesi konform Nenit 108/A, paragrafi 8.4.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakti 1. Paragrafi 9 i nenit 28 te LPP-së, Neni 28, Specifikimet teknike:
Paragrafi 9. *Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.*

Fakti 2. Neni 59, paragrafi 2 i LPP-së, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Paragrafi 2.
Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Fakti 3. Neni 108/A, paragrafi 8.4, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve:
8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:
8.4. autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.(05L/068)

Fakti 4. Pjesë nga dokumenti: *"Specifikimi teknik për Softwerin ERP _Iber Lepenc.docx"* të cilat sipas AK nuk janë plotësuar nga OE ankues.

2. Kërkesat specifike dhe domosdoshme të sistemit
- Duhet te mundesoje te perdoret ne platforma te ndryshme: web (chrome, firefox, safari, brave internet explorer etj), mobile (android dhe IoS), windows
- Sistemi duhet të përkrahë arkivimin(backup) automatikë si dhe kthimin e të dhënave paraprake në raste të ndonjë problemi (automatic backup and restore of database)

3. Moduli I Financave
- Sistemi dueht te mundesoje lidhjen e pagesave me faturat e caktuara. Ne rast te mos selektimit, sistemi duhet te perkrahe metoden e lidhjes se pagesave me faturen "nga me e vjetra" (from the oldest)
- Sistemi duhet te mundesoje perllogaritjen e kostos se mallit se paku sipas metodes mesatare dhe FIFO

4. Blerja
- Duhet te suportohet gjurmimi I artikujve sipas numrave serik dhe datave te skadences

5. Moduli I HR dhe PAGAVE
- Sistemi duhet te ofroje nje modul te self servisit, I cili ofron keto informacione:
  - Kerkesat per pushime, duke marre aprovimet paraprake nga personat pergjegjes ne hierarkine e konpanise
  - Te ofroje shikimin e te dhenave te profilit te tij
  - Te ofroje shikimin e oreve, vonesave dhe dalje nga acces kontrolli,
  - Te ofroje krijimin e raportit per totalin e oreve , vonesat, kohen e pauzës, orët e pushimeve
  - Te mundesoje te shikoje historikun e pagave te cilat I ka pranuar me pare I punesuari

Fakti 5 për pretendimin 1, nga dokumenti i OE ankues ***"3. Oferta Teknike-Asseco SEE.pdf"*** faqe 22.

SOUTH EASTERN EUROPE



Shtresa UI apo nderfaqja e sistemit e cila prezantohet na shfletuesi i interneti eshte pergjegjese per gjenerimin dhe renderimin e HTML dhe ekzekutimin e JavaScript kodit.

Shtresa Application eshte pergjegjese per vendosjen e komunikimit ma shtresen te dhenave dhe gjenerimin e gjitha formave te nderfaqes.

Fakti 6. Projektet e ngjashme të realizuara nga OE ankues.

1.1. PROJEKTE TE NGJASHME TE REALIZUARA

Nr.	Klienti	Emri i Kontrates
1	KUR Mitrovica	Development, delivery and installation of an Integrated Financial Management and Accounting Information System software (IFMAIS) for Mitrovica Regional Water Company
2	Bifurkacioni sh.a	Furnizim dhe Implementim te sistemit informativ te ndermarrjes (Faturimi dhe ERP)
3	Raifeissen Bank Albania	Implementimi I Call Center – Asseba Live
4	KUR Prishtina	Supply and Implementation of ERP and Billing System for RWC Pristina
5	EHV GMBH	Sherbime te zhvillimit, Implementimit dhe mirembajtjes se sistemit per shitje dhe distribucion mobil
6	Banka per Biznes	Dilivered and successfully implemented ASEBA JIMBA Mobile Banking solution for Banka per Biznes
7	Hidroregjioni sh.a	Mirembajtja dhe administrimi I aplikacionit softverik dhe perkrahja e shfrytezuesve
8	UNDP	Development of Monitoring Anti-Corruption Strategy and Integrity Plans Software for Kosovo Anti-Corruption Agency

Fakti 7. Deklarata e OE ankues për plotësimin e kërkesave funksionale dhe jo funksionale.

asseco
SOUTH EASTERN EUROPE

Asseco SEE

DEKLARON

Se do ti permbush te gjitha kerkesat funksionale dhe jo unkcionale nga dosja e tenderit "Furnizimi dhe instalimi i softwerit sistemi ERP" me numer te prokurimit IL-19-9673-1-2-1 dhe numer te brendshem IL-19-042-121, sipas afateve dhe kushteve te kerkuara nga autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderit.

Kohezgjatja e sherbimeve te mirembajtjes pas pranimit final: 6 muaj

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Oferta e OE ankues është vlerësuar si e papërgjegjshme.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi 54-20 i P.SH. të OSHP-së i datës 02.03.2020, lidhur me ankesën e OE "PBC", ku ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe obligohet AK qe të bëjë përmirësimin e Dosjes së Tenderit.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues dhe ai teknik japin këtë mendim si në vijim:

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 1, shkelje nga AK e Nenit 28 paragrafi 9 i LPP-së:

Ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka konsideruar se ASSECO SEE është i papërgjegjshëm duke qene se nuk i ka plotësuar specifikat teknike te dosjes se tenderit te listuara si ne njoftimin e dhënë.

a) *Kërkesa 2.2: Duke marre parasysh qe sistemi i ofruar është platforme UEB nënkupton qe sistemi funksionon ne browser te ndryshëm përfshire Firefox edhe ne platformën mobile.*

Eksperti shqyrtues teknik bazuar ne faktet 1, 5, 6 dhe 7 të kësaj ekspertize,për pretendimin ankimor 1 dhe për pjesët të cilat ky pretendim ankimor i përfshinë,deklaron qe OE ankues në ofertën teknike te tij nuk e ka cekur që sistemi i ofertuar nga ai funksionon edhe me shfletuesin Mozilla Firefox por i ka cekur shfletuesit: "Safari, IE dhe Google Chrome", por absolutisht nuk dyshoj qe të njëjtës platformë nuk mund ti qasen përdoruesit edhe nëpërmjet shfletuesit "Mozilla", por në mungesë të ndonjë paragrafi te shkruar ku cekët kjo gjë apo ndonjë deklaratë te OE ankues ku është e paraqitur decitivisht që i njëjti është i qasshëm për përdoruesit edhe nëpërmes shfletuesit "Mozilla" e konsideroj si pjesërisht **të bazuar** pretendimin ankimor 1a.

b) Kërkesa 3.8: Sistemi jone i ofruar është sistem i cili aktualisht funksionon ne ndërmarrje publike qe kane faturim masiv dhe qe e përdorin lidhjen e pagesave me fatura sipas parimin nga "me e vjetra" andaj kjo kërkesë mundësohet përmes sistemit tone dhe është pjese e konfigurimit te sistemit gjate implementimit.

Eksperti shqyrtues teknik bazuar në referencat, kontratat dhe rekomandimet të cilat OE i ka bashkangjitur ne Ofertën e tij, konsideron se edhe kjo pjesë e pretendimit **është e bazuar** dhe mënyra e lidhjes së pagesave me faturat është e konfigurueshme gjatë implementimit.

c) Kërkesa 2.10: Automatic Backup and Restore mundësohet nga sistemi jone i ofruar dhe kjo konfigurohet gjate fazës se implementimit.

Eksperti shqyrtues teknik bazuar në kontrollimin e detajuar të ofertës teknike te OE ankues, mënyrës se prezantimit te projektit, realizimit dhe funksionalizimit të tij, si dhe nga përvoja ime personale konsideroj që edhe pjesa **c)** e pretendimit ankimor **është e bazuar.**

d) Kërkesa 3.14: Është veçori standard e sistemeve ERP andaj edhe sistemi i ofruar nga ne e përkrahë përllogaritjen e kostos se mallit sipas metodës FIFO.

Eksperti shqyrtues teknik për pjesën **d)** te pretendimit ankimor 1 konsideron se edhe kjo pjesë e pretendimit ankimor **është e bazuar**

e) Sistemi i ofruar nga ne është i konfigurueshem andaj mund te konfigurohet qe te mundësohet gjurmimi i artikujve sipas numrit serik.

Eksperti shqyrtues teknik për pjesën **e)** te pretendimit ankimor 1 konsideron se edhe kjo pjesë e pretendimit ankimor **është e bazuar**

f) Sistemi i ofruar nga ne është platformë e hapur për integrime te ndryshme përfshire edhe atë me access control. Si produkt final pas implementimit sistemi i ofruar nga ne përfshinë edhe Self Service i cili gjate fazës se implementimit konfigurohet sipas kërkesave specifike te autoritetit kontraktues.

Eksperti shqyrtues teknik për pjesën **f)** te pretendimit ankimor 1 konsideron sete pretendimit ankimor 1 konsideron se edhe kjo pjesë e pretendimit ankimor **është e bazuar.** Kjo dëshmohet me referencat dhe kontratat e bashkangjitura ne dosjen e tenderit te dorëzuar nga OE ankues si dhe duke u bazuar në faktin 7 të kësaj ekspertize

Në lidhje me pretendimin ankimor 1 **shkelje nga ana e AK-së e Nenit 28 paragrafi 9 i LPP-së, Eksperti Teknik** konsideron se gjatë shqyrtimit te ofertave te dorëzuara nga OE pjesëmarrës në ketë aktivitet te prokurimit publik, AK-ja nuk e ka ndjekur me saktësi paragrafin 9 te nenit 28 të LPP-së duke mos marr parasysh dokumentacionin e dorëzuar nga ana e OE ankues, andaj Pretendimin 1 te tij e konsideron si **plotësisht të Bazuar**.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 2, shkelje nga AK e Neni 59 paragrafi 2:
Nëse AK do te kishte dilema se tenderi i ASSECO SEE nuk i përkrah ndonjërën nga kërkesat e parashtruara ne dosje te tenderit, edhe pse askund ne ofertën/tenderin e ASSECO SEE nuk konfirmohet se ndonjë kërkesë nuk mund te përkrahet nga sistemi i ofruar dhe përkundrazi është deklarata e ASSECO SEE e cila konfirmon pikërisht te kundërtën e konstatimit te AK se ne tenderin e ASSECO SEE ka kërkesa qe nuk përkrahen nga sistemi i ofruar, AK do te duhej te zbatonte nenin 59.2 te LPP-se duke kërkuar informata shtese nga ASSECO

SEE lidhur me sqarimin e cilitdo nga aspektet e tenderit te tij.

Duke marrë parasysh faktet e bashkëngjitura dhe kronologjinë e ngjarjes që nga njoftimi për kntratë, tek kërkesat për sqarime, ankesa e parë, vendimi i OSHP, përmirësimet e gabimeve, kërkesat për rishqyrtim pastaj prapë përmirësimi i gabimeve e deri te ankesa e tanishme, Eksperti Teknik dhe ai Shqyrtues konsiderojnë që AK nuk ka respektuar nenin 59 duke mos kërkuar informata shtesë në lidhje me arsyetimet për refuzimin e ofertës së OE ankues.

Konstatimi i ekspertit teknik për pretendimin ankimor 3, shkelje nga AK e nenit 108/A, paragrafi 8.4: *Ne arsyetimin e vendimit te AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim te vendimit për eliminim, AK ne asnjë pjese te saj nuk e ka shqyrtuar çështjet qe janë ngritur nga Ankuesi lidhur me shkeljet e supozuara te nenit 28.9 i LPP-së dhe Nenit 59 paragrafi 2. Vendimi i AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim është përsëritje e arsyetimeve nga njoftimi për eliminim dhe nuk ka adresim te çështjeve qe janë kërkuar nga ankuesi konform Nenit 108/A, paragrafi 8.4.*

Eksperti shqyrtues teknik, bazuar në Faktin 3 te kësaj ekspertize, analizimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe përgjigjen ne të nga ana e AK-së, raportin e vlerësimit si dhe njoftimin për vendimin e AK-së, konsideron se arsyetimet për refuzimin e ofertës se OE ankues janë identike e po ashtu edhe përgjigja në kërkesë për rishqyrtim, andaj ketë pretendim ankimor e konsideroj **si të Pabazuar** ngase AK gjegjësisht komisioni vlerësues dhe personat përgjegjës qe kanë kthyer përgjigje thjesht janë bazuar në kërkesat e Njoftimit për kontratë, DT dhe Njoftimeve për përmirësimin e gabimeve e të cilat nuk i kanë hasur në dokumentacionin e dorëzuar nga OE ankues.

Marrë parasysh adresimin e pretendimeve të lartpërmendura, Ekspertët shqyrtues konsiderojnë që Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform nenit 28.9 dhe 59.2 të LPP-së, duke mos saktësuar kërkesat dokumentare për arsyetim të plotësimit të kërkesave teknike nga ana e operatorëve ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në këtë procedurë, gjë që ka vonuar procedurën dhe ka pamundësuar ofertim të njëtrajtshëm të OE.

Bazuar në sqarimet e cekura ne raportin e ekspertizës, Ekspertet shqyrtues i propozojnë panelit shqyrtues të OSHP-së që ankesa e OE"ASSECO SEE" SH.P.K. të merret parasysh si pjesërisht e bazuar dhe të obligohet AK që procedurën e prokurimit ta anuloj, dhe që me ritenderim të procedurës t'i avancojë kërkesat, duke u fokusuar në veçanti në ato teknike, gjithmonë duke vepruar konform dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe ai teknik i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe të anulohet aktiviteti i prokurimit

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A.".**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **"ASSECO SEE" SH.P.K. - Prishtinë**